



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKPP
Nr. l faq.
Broj stranica
Nr. pages 03

Nr. Prot.
Procs No. 03-08/3262/16
Data
Datum 26.09.2016
Date

P. TIME



DATË/A:	23/09/2016
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Sadri EMËRLLAHU U.D. I Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Drejtësisë
CC:	z. Esat RAMA Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Ridizajnimi i web faqes së MD-së"



I nderuari z. Emërllahu,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin “**Ridizajnimi i web faqes së MD-së**”, me numër prokurimi: 21500 16 014 236, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin “**Ridizajnimi i web faqes së MD-së**”, me numër prokurimi: 21500 16 014 236, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Ministria e Drejtësisë, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull “Ridizajnimi i web faqes së MD-së”, me numër prokurimi: 21500 16 014 236 i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.19/09/2016. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi Prokurimit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar faktet si në vijim:

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Agjencia ka vërejtur se si kriter për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka caktuar kriterin *Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*, ndërsa si nën kritere i ka vendosur **1.** Çmimi 60 %, **2.** Përvoja e punës e shprehur në referenca për kontrata të përfunduara me peshë prej 10 %, **3.** Karakteristikat funksionale (të dhënat me USB ose CD) të cilin e ka peshuar me 20 %, **4.** Shërbimet pas ridizajnit me peshë prej 10%.

Lidhur me nën kriterin 2 Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nën kriteri i tillë nuk mund të përdoret në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues. Po ashtu autoritet kontraktues ka bërë përsëritje të nën kritereve 2 dhe 3 ti cilat i ka përdorur edhe si kërkesa tek kriteret e përzgjedhjes.

Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas legjislacionit të prokurimit publik kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës dhe nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive.

Me tutje gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dosjes së tenderit, Agjencia ka vërejtur se Njësia e Kërkesës i ka propozuar gjithashtu edhe kriteret për dhënien e kontratës e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, ku përcaktohen qartë funksionet e njësisë kërkuese dhe njësisë së prokurimit, andaj secila duhet veproj komfor përgjegjësi që ka.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **31**, nenin **32** të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 si dhe nenin **9** Funksionet e njësisë së kërkesës të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !